



Bordi i Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP),

Në mbështetje të nenit 15.2.1 të Ligjit të AKP-së,

Në mbështetje të nenit 18.1.12 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së,

Miraton:

**RREGULLORE NR.09/2023 PËR ANGAZHIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE NË
PROCESIN E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i rregullores është të përcaktohen hapat të cilët duhet të ndiqen për udhëheqjen e një procedure për angazhimin e Ofriuesve të Shërbimeve (OSh) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh).

**Neni 2
Kategoritë e Ofriuesve të Shërbimeve**

1. Neni 18.1.12 parashev që Autoriteti i Likuidimit (AL) mund të angazhoj/kontraktoj Ofriues të Shërbimeve - OSh për t'i ndihmuar AL-së gjatë zhvillimit të procesit të likuidimit.
2. AL mund të angazhoj Ofriues të Shërbimeve për këto detyra:
 - 2.1. ekspertizë (p.sh. juristë, ekonomistë, ekspertë kadastral apo persona tjerë të kualifikuar) për të ndihmuar AL-në në kryerjen e detyrave të saj që nuk janë përcaktuar si përgjegjësi direkte e kontraktorit si Ofriues i Shërbimeve Profesionale;
 - 2.2. punët administrative në kuadër të NSh-së;
 - 2.3. punët arkivore në kuadër të NSh-së;
 - 2.4. mbrojtja dhe siguria e aseteve të NSh-ve.
3. AL ka mundësi për angazhimin këtyre kategorive të personave:
 - 3.1. Ish-menaxhmenti i NSh-së;
 - 3.2. Ish të punësuarit e NSh-së;

- 3.3. Ekspertë të jashtëm (të referuar në nenin 2.2.1 të kësaj rregulloreje);
- 3.4. Persona tjerë me kualifikime përkatëse që përshtaten me detyrat e dhëna.
4. Gjatë angazhimit të OSh-ve prioritet iu jepet kurdo që është e mundur ish-punëtorëve të NSh-së dhe të cilët nuk kanë ndonjë alternativë tjetër të punësimit apo angazhimit.
5. Nëse nuk arrihet të angazhohen ish-punëtorët e NSh-së, atëherë mund të angazhohen persona tjerë të kualifikuar sipas nevojave dhe natyrës së punës që duhet të kryhet.

Neni 3
Procedura e angazhimit të Ofruesit e Shërbimeve

1. Për OSh-të të cilët angazhohen për detyrat e parapara në nenin 2.2.1 të kësaj rregulloreje do të zbatohet Udhëzimi nr. 1/2009 për procedurat e prokurimit me fondet e NSh-ve në likuidim;
2. Për angazhimin e OSh-ve tjerë sipas kësaj rregulloreje do të përdoret procedura e hapur konkurruese, për të cilën ftesa publike do të bëhet në faqen e internetit të AKP-së:
 - 2.1. Për procedurën konkurruese sipas nenit 3.2 të kësaj rregulloreje do të përdoren formularët në shtojcë të kësaj rregulloreje dhe sipas nevojës do të përdoren përshtatshmërisht edhe formularët tjerë të paraparë në Rregullat për Prokurim të Shërbimeve të Veçanta të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik apo formularët e Divizioni i Burimeve Njerëzore të AKP-së;
 - 2.2. Ofertat do të dorëzohen në adresë të caktuar në zyret e Agjencisë dhe me afat brenda afatit prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes publike për angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve;
 - 2.3. Një Komision për vlerësim i përbërë prej tre anëtarëve, njëri prej të cilëve do të jetë Anëtar i AL-së, do të themelohet nga Drejtori Ekzekutiv i AKP-së;
 - 2.4. Komisioni vlerësues vlerëson ofertat sipas kritereve të njoftuara të zgjedhjes, refuzon refuzohet çdo plotësim/ndryshim të mëvonshëm të ofertave, të rekomandohet ofertën që siguron vlerën më të mirë, rekomandon Drejtorin Ekzekutiv për Ofruesin e Shërbimeve që do të përzgjedhet për të nënshkruar kontratën;
 - 2.5. Procedurën konkurruese e drejton Kryesuesi i AL-së.

Neni 4
Kostoja e angazhimit të Ofruesit e Shërbimeve

1. Kostot për OSh-të të cilët angazhohen për detyrat e parapara janë:
 - 1.1. Për detyrat sipas nenit 2.2.2 dhe 2.2.3 të kësaj rregulloreje kostoja është EUR 450;

- 1.2. Për detyrat sipas nenit 2.2.4 të kësaj rregulloreje kostoja është EUR 330;
- 1.3. Në shumat e mësipërme përfshihen edhe pagesa për kontributet pensionale (5%) nga punëdhënësi dhe (5%) nga punëmarrësi dhe tatimit në burim sipas legjislacionit në fuqi.
- 1.4. Për detyrat sipas nenit 2.2.1 të kësaj rregulloreje zbatohet kostoja sipas procedurës së prokurimit me Udhëzuesin nr. 1/2009 për prokurimin me fondet e likuidimit:
 - 1.4.1. Në rastet e angazhimit të individëve si kontraktor/Ofrues i Shërbimeve, atëherë në kosto përfshihen edhe pagesa për kontributet pensionale (5%) nga punëdhënësi dhe (5%) nga punëmarrësi dhe tatimit në burim sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.4.2. Në rastet e angazhimit të kompanive, atëherë zbatohen normat timore sipas Ligjit për Administratën Tatimore të Kosovës dhe legjislacionit tjetër tatimor në fuqi.
2. Buxheti për OSh-të do të përdoret vetëm nga fondet e NSh-së në likuidim;
3. Në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme nga llogaritë e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse për të mbuluar kostot e mbrojtjes dhe sigurimit të pronës, atëherë kostot e OSh-ve do të mbulohen nga tarifa administrative e Agjencisë.
4. Përashtimi nga nënparografi 1.1 dhe 1.2 i paragrafit 1 të nenit 4, Drejtori Ekzekutiv dhe Kryesuesi i Autoritetit të Likuidimit i përcaktojnë me shkrim kostot për OSh-të të cilët angazhohen në Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim të cilat kanë aktivitet operativ.

Neni 5 Periudha e angazhimit të Ofruesit e Shërbimeve

1. Periudha e angazhimit të OSh-ve sipas kësaj rregulloreje për NSh-të operative është një (1) vjeçare me mundësi të vazhdimit sipas nevojës së përcaktuar nga Autoriteti i Likuidimit dhe Menaxhmenti i AKP-së.
2. Periudha e angazhimit të OSh-ve sipas kësaj rregulloreje për NSh-të tjera është tre (3) deri në gjashtë (6) muaj. Vazhdimi i angazhimit të OSh-ve për këto NSh lejohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme e të argumentuara me shkrim nga Autoriteti i Likuidimit dhe miratuar nga Drejtori Ekzekutiv i AKP-së.

Neni 6 Dokumentet mbështetëse për angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve

1. Dokumentet mbështetëse të inicimit të angazhimit të OSh-ve janë:
 - 1.1. Deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve për angazhimin e OSh-ve; dhe
 - 1.2. Raporti analistik për angazhimin e OSh-ve.

2. Deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve për angazhimin e OSh-ve përmban: shpalosjen e gjendjes faktike lidhur me informatat themelore për NSh-së; nevojën e angazhimin; periudhën e angazhimit; koston e angazhimit; detyrat e parapara të OSh-së; historiku rreth angazhimit të OSh-ve në të kaluarën për këtë NSh dhe cilat janë detyrat që ende nuk janë përfunduar; informata tjera jo-financiare dhe analiza tjera të cilat dëshmojnë nevojën e angazhimit të OSh-ve;
3. Raporti analistik për angazhimin e OSh-ve përmban: analizat financiare; buxhetin e aprovuar nga Bordi kundrejt shpenzimeve të krijuara deri në periudhën paraprake; likuiditeti bankar – nëse NSh-ja është duke gjeneruar të hyra të cilat mund të mbulojnë këto aktivitete. Rastet kur NSh-të nuk janë duke gjeneruar të hyra, por pritet që në të ardhmen të shiten asetet, atëherë të ofrohet një analizë rreth vlerës së përafërt të aseteve.

Neni 7
Kontrata për angazhimin e Ofriuesit e Shërbimeve

1. Kryesuesi i Autoritetit të Likuidimit do të nënshkruaj kontratat standarde për OSh-të të cilat janë përgatitur për këtë qëllim;
2. Kontrata e OSh-së përfshin: përshkrimin e detyrave të punës të cilat duhet të jenë në përputhje me deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve, koston e kontratës, periudhën, ligjin e zbatueshëm.
3. Kontratat e Ofriuesve të Shërbimeve nënshkruhen nga Kryesuesi i AL-së së NSh-së përkatëse në likuidim.

Neni 8
Raportimi për detyrat e Ofriuesit e Shërbimeve

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tij, secilit OSh do t'i kërkohet që të raportoj për kohën e vet të kaluar dhe të specifikoj detyrat e punën që e ka kryer;
2. Zyrtari i Rastit është përgjegjës që të monitoroj në vazhdimësi kryerjen e këtyre punëve duke u siguruar se ato kryhen brenda afatit dhe me cilësi të kërkuar;
3. Zyrtari i Rastit dhe Kryesuesi i AL-së verifikojnë kohën e harxhuar për kryerjen e këtyre punëve/detyrave në formularin “dëshmia e prezencës në punë” (ang. “time sheet”).

Neni 9
Pagesa e Ofriuesve të Shërbimeve

1. Në mënyrë që të kryhet pagesa për ofriuesit e shërbimeve, Kryesuesi i Autoritetit i Likuidimit dhe Zyrtari i Rastit i AL-së do të paraqesin Kërkesën–Memorandumin për pagesë drejtuar Departamentit të Financave edhe Buxhetit të AKP-së;
2. Kërkesa-memoradumi për pagesë duhet të përfshijë:

- 2.1. periudhën, vlerën e pagesës, emrat e OSh-ve, numrin e OSh-ve dhe të svaroj çdo ndryshim që ka ndodhur në listën e OSh-ve; formularin e pagesës; dëshmia e prezencës në punë (ang. “time sheet”) me detyrat e kryera sipas ditëve; kërkesë-fatura dhe kopjen e kontratës për Ofritesit e Shërbimeve”;
- 2.2. kopja e deklaratës së nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve (e miratuar para angazhimit të OSh-ve) dhe raportit analistik (e miratuar para angazhimit të OSh-ve).

Neni 10
Angazhimi i OSh-ve në ndërmarrjet nën administrim direkt të Agjencisë

1. Për personat e NSh-ve nën administrim direkt që kanë marrëdhënie aktuale të punës me NSh-në do të zbatohen dispozitat e Rregullores nr. 2/2020 për punën e administritmit direkt të miratuar nga Bordi i Drejtoreve;
2. Për OSh-të tjerë që kërkohet të angazhohen për NSh-të nën administrim direkt do të zbatohet kjo rregulllore përshtatshmërisht.


Neni 11
Ligji i zbatueshëm për kontratat e OSh-ve

Kontratat për Ofritesit e Shërbimeve për NSh-të në likidiim interpretohen sipas Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëni e detyrimeve dhe Ligjit të AKP-së dhe Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 28 shtator 2023.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.

Mentor Hyseni

Kryesues i Bordit të Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Shtoja 1: Deklarata e nevojës dhe disponueshmërisë së fondeve për OSh-të; dhe
Shtoja 2: Raporti analistik për angazhimin e OSh-ve.

FORMULAR I VLERËSIMIT TË NEVOJAVE DHE DISPONUESHMËRISË SË FONDEVE PËR ANGAZHIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE NË PROCESIN E LIKUIDIMIT

Emri i NSh-së në Likuidim	[shëno emrin]
Referanca e angazhimit	[shëno numrin referent]
Emri dhe nënshkrimi i Kryesuesit të Autoritetit të Likuidimit	[shëno emrin dhe nënshkruaje]
Emri dhe nënshkrimi i Zyrtarit të Rastit të Autoritetit të Likuidimit	[shëno emrin dhe nënshkruaje]

Data e Vlerësimit të Nevojës	
Periudha e angazhimit	
Vlera e Transaksionit të Vlerësuar në €	

Natyra dhe fushështrirja e saktë e nevojës specifike të cilën do të plotësoj Autoriteti i Likuidimit

Vërtetoj që e lartpërmendura është kërkesë për aprovim të angazhimit të Ofruesit të Shërbimeve për vlerën totale të angazhimit që nuk tejkalon buxhetin e miratuar nga Bordi i Drejtoreve për NSH-në në likuidim

Emri, mbiemri dhe Nënshkrimi i Kryesuesit të Autoritetit të Likuidimit

DËRGUAR PËR APROVIMIN E MENAXHMENTIT TË AKP-së

[shëno emrin]	Aprovuar / Refuzuar	Nënshkrimi/Data
Drejtor Ekzekutiv Agjencja Kosovare e Privatizimit		

RAPORTI ANALITIK PËR ANGAZHIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

MOSTËR

NR. IDENTIFIKUES I NDËRMARRJES SHOQËRORE	PRN004
EMRI I NDËRMARRJES SHOQËRORE	NUMRI I LLOGARISË BANKARE
Lavertari - Blektori	1000510000011522

TABELA 1 - SHPALLOSJA E GJENDJES FAKTIKE TË NDËRMARRJES SHOQËRORE:

Ndërmarrja Shoqërore PRN004 Lavertari - Blektori ka filluar procedurat e likuidimit me datë dd/mm/vvvv në përputhje me vendimin e Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Autoriteti i likuidimit i NSh "....." është themeluar në pajtim me dispozitat e ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

PËR SHEMBULL PARAQIT GJENDJEN FAKTIKE TË ARKIVËS, RUAJTJEN DHE MIREMBAJTJEN E ASETeve ETJ.

TABELA 2 - KONKLUZIONE DHE PROPOZIMET E ANGAZHIMIT TË Osh-ve.

Në cilësinë e Zyrtarit të Rastit pranë Autoriteti të Likuidimit (AL) në " ndërmarrja" në konsultim me Udhëheqësin e Ekipit të Likuidimit dhe Menaxherin e ZR....ju adresoj kërkesën për angazhimin e Ofruesve të shërbimeve për këto aktivitete:

SPECIFIKO ANËT POZITIVE TË ANGAZHIMIT TË OFRUESVE TË SHERBIMEVE DHE CILAT DO TË ISHIN NGECJET E MOS ANGAZHIMI TË TYRE.

RAPORTI ANALITIK PËR ANGAZHIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

TABELA 3 - ANALIZAT FINANCIARE PËR ANGAZHIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

Numri	Përshkrimi	KUTIA
3.1 ANALIZA BUXTORE		
1	Buxheti i likuidimit i aprovar nga Bordi i Drejtoreve	30,660.00
2	Shpenzimi i buxhetit të likuidimit deri më datën 15 Maj 2015	6,360.57
3	Gjithsej kostoja e angazhimit të ofruesve të shërbimeve (numri i Osh-ve*pagesa mujore*numri i muajve)	3,000.00
4	Shpenzimet e tjera të planifikuara	8,000.00
5	Shuma totale e cila duhet kompenzuar llogaria e tarifës administrative (nëse ka pagesa nga tarifa admi.të buxhetit të likuidimit si. p.sh paraja e imët për taksa gjyqësore)	579.70
6=Σ(1-(2:5))	Ju keni buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e kostos së këtij angazhimi	12,719.73
3.2 ANALIZA E LIKUIDITETIT		
7	Gjendja bankare deri më datën 15 Maj 2015	2,128,833.32
8	Shuma totale e cila duhet kompenzuar llogaria e tarifës administrative (pagesat e kostove fikse dhe variabile ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale apo të tjera që nuk janë brenda kornizës buxhetore të likuidimit)	-
9	Shitjet të cilat priten të ndodhin të tilla: shitja e aseteve përmes likuidimit, shitja e banesave apo cfarëdo shitje tjeterë	-
10	Të hyrat të cilat priten të ndodhin nga qiraja e kontraktuar apo të hyrat të tjera nga aktiviteti operativ i Ndërmarrjes Shoqërore	-
11=Σ(7-8+9+10)	Gjithsej likuiditeti i llogarisë bankare të i Ndërmarrjes	2,128,833.32
12=Σ(11-(3+4+5))	GJENDJA E RRJEDHËS TË PLANIFIKUAR TË PARASË SË GATSHME	2,117,253.62
*Pika 1, 2, 5 dhe 8 vlejnë vetëm pë ndërmarrjet në likuidim		
3.3 INFORMATAT TË TJERA		
1. A keni angazhuar më përpara ofrues të shërbimeve? Nëse po, ofroni detaje rreth numrit, natyrës së angazhimit, periudhës kohore dhe kostos.		
<hr/> <hr/> <hr/> <hr/>		

Përgatitur nga:

Emri dhe Mbiemri _____

Data: _____

Zyrtar i Rastit NSh

Aprovuar nga:

Emri dhe Mbiemri _____

Data: _____

Kryesuesi i AL /
